Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhepërdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e kërkuar.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

“REÇEL” CILËSIA E I-rë

Bazuar ne STASH 1477/87 Lloji i reçelit:

1. Reçel kumbulle
2. Reçel qershie

Sasia dhe lloji i reçelit do të jetë sipas kërkesës së AK.

Treguesit cilësorë të reçelit:

Pamja e ngjyra: E mirë, me fruta me ngjyrë të njëllotjë, karakteristike e llojit, pa bërthamë dhe farë.

Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Konsistenca:Masë e njëllotjë, viskoze deri xhelatinoze me fruta me zierje normale.

Treguesit fiziko-kimikë:

Lëndët e thata sipas refraktometrit në 20 gradë C jo më pak se 65 %

Sheqer gjithësej (sheqer saharoz dhe I vetë frutit) jo më pak se 55%

Aciditeti i shprehur në acit tartik, %, jo më shumë se 1.3

Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda në mg/kg produkt jo më shumë se:

• Kallaji _____	100
• Bakri _____	10
• Zinku _____	10
• Plumbi _____	0.1
• Arseniku _____	0.2

Shenja myku dhe fermentimi nuk lejohen

Lëndë të huaja nuk lejohen.

Raport analiza Fiziko – kimike duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Amballazhimi:

Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi ose plastike, apo me peshe 300 gr - 1 kg, me etikete dhe të jete i shoqëruar me raport të rregullt analize sipas legjislacionit ne fuqi.

Cilesia e recelit duhet të jete ne perputhje me lenden e pare qe eshte perdour per prodhim dhe sipas kerkese se Autoritetit kontraktor.

Markerimi:

- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit .
- Pesha neto
- Data e prodhimit .
- Data e skadimit.
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.
- Produkti duhet të shoqërohet me:
- Raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport analizë mikrobiologjike.

Raport Analizat duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

“SALCË PËR GATIM”

Bazuar në SSH 1429: 1987 ose ekuivalentin e tij.

Treguesit cilësorë:

Pamja e jashtme: Masë pastoze, me pjesë të dukshme të përbërësve të saj, pa pjesë të djegura.

Ngjyra: E kuqe deri e kuqe e thellë.

Shija dhe era: Me shije dhe erë karakteristike të salcës së domates dhe përbërësve të tjerë.

Treguesit Fiziko –Kimik:

Lëndë të thata të matura me refraktometër në % të jetë 20 ± 1 .

Aciditeti i shprehur në acid citrik në %: jo më shumë se 2.5 %

Përmbajtja e vajit vegjetal të rafinuar në % 9-10.

Përmbajtja e metaleve të rëndë, mg/kg produkt, jo më shumë se:

- Bakër 30
- Kallaj 50
- Plumbi 0.3

Ngarkesa mikrobike: Brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ambalazhimi dhe etiketimi Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Salca e gatshme për gjellë ambalazhohet në ambalazh metalik (llamarine)/shishe, të mbyllura hermetikisht me peshë sipas kërkesave të AK.

Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produkti,
- Peshë neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit.
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi: Salca e gatshme për gjellë ruhet sipas kushteve të këtij standardi deri në 12 muaj nga data e prodhimit.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

“KRIPË E JODIZUAR”

Bazuar në STASH 1437\01.07.1995

Lloji: Kripe ushqimore perpunuar dhe e bluar për përdorim në guzhinë.

Ngjyra : E bardhë

Era dhe shija : E kripur pa shije dhe ere të huaj.

Pamja : Mase kokrrizore.

Treguesit fiziko-kimikë:

Imtesia në mm 0.2 – 2.

Klorur Na në lenden e thate në %, jo më pak se 98.

Klorur Mg në lenden e thate në %, jo më shumë se 0.3.

Sulfat Mg në lenden e thate në %, jo më shumë se 0.9.

Sulfat Ca ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.2.

Lende të patretshme ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.3.

Lageshtire ne %, jo me shume se 1.

Jodur kaliumi mg/kg 50 + - 3.

Kripa të plotesoje të gjithë kerkesat higjieno-shendetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shendetsise.

Marketimi:

- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit.
- Pesha neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit.
- Data e skadimit.
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbietiketë.

Ambalazhimi: Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimore, pesha 0.5 deri 1kg.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jënë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje tëparë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jënë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

“VANILJE”

Kerkesat cilesore:

Pamja: Pluhur i thatë, me arome dhe shije te kendshme karakteristike te vaniljes.

Ngjyra: Te jete e bardhe. Nuk lejohen papasterti te ndryshme.

Treguesit Fiziko –Kimike:

Lageshtia: Jo me shume se 14% Lende te huaja: Nuk lejohen

Ambalazhimi: Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj, me peshe nga 10gr - 50gr.

Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur dhe emri tregetar, data e prodhimit , vendi i prodhimit, menyra e ruajtjes dhe skadenca.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

“KANELLË”

Kerkesat cilesore

Pamja: Pluhur i thatë, e shije dhe erë karakteristike të kanellës. Ngjyra: E kuqërremtë Nuk lejohen papasterti te ndryshme.

Treguesit Fiziko –Kimike

Lageshtia: Jo me shume se 14% Lende te huaja: Nuk lejohen

Ambalazhimi: Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj, me peshe nga 30gr - 100gr.

Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur dhe emri tregetar, data e prodhimit ,vendi i prodhimit,menyra e ruajtjes dhe skadenca.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

“ARRË MOSKAT”

Kerkesat cilesore

Pamja e jashtme: Te jene te thata, me arome dhe shije te kendshme karakteristike te vete bimes.

Ngjyra: Gri në kafe. Nuk lejohen papasterti te ndryshme.

Treguesit Fiziko Kimike

Lageshtia: Jo me shume se 14% Lende te huaja: Nuk lejohen

Ambalazhimi:

Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj, me peshe nga 50gr - 100gr.

Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur dhe emri tregetar, data e prodhimit ,vendi i prodhimit,menyra e ruajtjes dhe skadenca.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

“ÇAJ MALI ”

Bazuar në SSH 966:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi: Cilësi e parë, i freskët

Treguesit shqisorë:

Pamja: Të jetë bar i thatë kërcelli me gjethe e lule të vegjetacionit të vitit në vazhdim me gjatësi 20-30 cm. Të jetë pa farë, pa rrënjë dhe jo i drunjëzuar. Aroma specifike e vet bimës e këndshme.

Ngjyra: Fletët dhe kërcelli të gjelbër në bojë hiri, lulja e verdhë në krem.. Nuk lejohen të nxira të mykura, të kalbura dhe papastërti të ndryshme. Nuk pranohet çaj me bustina. I ambalazhuar në pako ose me tufa.

Treguesit fiziko –kimik:

Lageshtia jo më shumë se 12 %.

Bar me ngjyrë jo normale jo më shumë se 5 %.

Lëndë organike të vetë bimës dhe bimëve të tjera jo helmuese, jo më shumë se 2 %.

Lëndë minerale jo më shumë se 1 %.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH 2500:1988: “Bimë mjekësorë, eterovajorë dhe tanifere. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi.” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Çaji ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Operatori ekonomik nga çdo prodhim ose grumbullim të caktuar nga i cili bën furnizimin në AK, të ketë certifikatë fitosanitare.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

“UJË NATYRAL”

Te jete i ambalazhuar ne bidona 6 lt. Uji te jete i paster mikrobiologjikisht. Me etikete ku te shenohen te gjithë perberesit kimike e kimiko-fizike qe duhet te permbaje.

Marketimi:

- Emertimi i prodhuesit
- Emertimi i produktit
- Pesha neto
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

FRUTA ZARZAVATE

“PATATE”

Bazuar në STASH 1729\88

Treguesit cilësorë të patates verore e dimërore:

Pamja e jashtme: Të plota, të forta, të pastra e të thata , jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

Pjekuria: Kokrra të pjekura. Madhësia e kokrrës (diametrik më i madh) mbi:

- Për të rrumbullaktat dimërore –5 cm; verore –4 cm
- Për vezaket dimërore dhe verore 4 cm.për të zgjaturat -3.5cm.

Lejohen:

- lehtësisht të gjelbra jo me shume se 3 % për dimëroret; 1 % përveroret;
- të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen përveroret;
- lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % përveroret;
- të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;
- të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;
- zgjebe me plagë deri në 1\5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 %.
- njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1\5e siperfaqës së kokrrës nuk lejohen;
- dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .
- Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

“KARROTA”

Treguesit cilësorë:

Pamja e jashtme: Të freskët me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta.

Përbërja e brendshme e tulit: Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm.

Madhësitë:

- Gjerësia (diametrik me i madh)deri në 4 cm,
- Gjatësia 10 -15 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në % jo më shumë se 2.

Të prekura nga sëmundjet, insektet e tëkalbura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“QEPË E THATË”,

Bazuar në STASH 1755\88

Treguesit cilësorë të qepës së njomë dhe të thatë:

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plotë. Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota. Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Diametri (madhësia e kokrrës): për ovalet 4-8 cm. për llojet e tjera 5-10 cm.

Dëmtime mekanike: Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e parties me dëmtime të lehta dhe 1 %

lëndë të huaja (cifla, bishta).

Me sëmundje: Nuk lejohen.

Të ngrira, të kalbura e të mykura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

Transporti _____ i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

“QEPË E NJOMË”,

Lloji : cilësi e parë, e freskët

Treguesit cilësorë:

Kërkohej cilësia e parë, të jenë të njoma, të freskëta, të pastra, të lara me ujë të pijshëm, me ngjyrë jeshile të gjetheve, të pa çara, të pa vyshkura e pa karabush.

Gjatësia e tufës të jetë pa kufizim dhe me bishta të pa prera.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Gjethet të verdha e të lagura, karabush të mëdhenj, të gjatë e të kalbur nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi:

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

“D O M A T E”

Bazuar në STASH 1726-88

Pamja e jashtme: Të freskëta, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të palagura.

Pjekuria dhe ngjyra: Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.

Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen.

Të plasura e të vrara lehtësisht: Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara), madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), jo me pak se:

- Për të hershmet 5 cm.

-
- Për të mesmet dhe të vonat 7 cm.
 - Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm).

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“P R E SH”

Bazuar ne STASH 1759-88.

Lloji: Presh per treg cilesia e pare.

Treguesit cilësorë

Pamja e jashtme. i fresket, i paster, i njome , me ngjyre të bardhe ne jeshile , i pavyshkur dhe i lare me uje të pijshem.

Diametri ne pjesen me të trashë, cm. Mbi 2.5-3.5cm .

Gjatesia e kercellit: ne cm.25-45 .

Gjatesia e gjethit: nga rozeta ,cm, jo me shume se 20cm

Sistemi rrenjor: cm,jo me shume se 1cm.

Demtime e semundje: Nuk lejohen .

Ambalazhimi dhe etiketimi: bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia .
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“KUNGULL“

Lloji :Kungull per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore :

Pamja e jashtme: Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte .

Perberja e brendshme e tulit:Me tul jo shume të forte. Farat e pa zhvilluara e me lekure te lemuar.

Madhesite:

- Gjeresia ne cm (diametric me i madh)deri3.
- Gjatesia ne cm nuk kerkoht.

Demtime mekanike (gervishtje të lehta ne lekur)ne % jo me shume se 2.

Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi .
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia .
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“LULELAKËR”

Lloji : Lule laker cilesi e pare.

Kërkesat cilësore:

Pamja e jashtme:Të zhvilluara, me mbeshtjellje fletesh, e forte ne prekje.Lejohen lule lakra të pangjeshura deri 5% të parties.

Pastrimi dhe gjatesia e koçanit: Të jene të pastruara dhe me 2-3 gjethe të gjelbera, të lidhura me koçanin i cili të jete deri ne 3cm.

Demtime të ndryshme mekanike semundje e të çara të lehta: Lejohen deri ne 5% e partise me demtime të lehta mekanike ,të çara lehtesisht e të shperthyera si dhe të demtuara lehtesisht nga bryma .Me semundje nuk lejohen .

Pesha e kokrres : Nga 0.5 kg – 1 kg

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia .
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“BROKOLI”

Pamja e jashtme:Te jene te fresket, te pjekur mire, me forme te rregullt, pa demtime mekanike.

Ngjyra: Te kene ngjyre karakteristike jeshile te forte te brokolit me permasa mesatare.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

-
- Prodhuesi .
 - Lloji i prodhimit.
 - Cilesia .
 - Masa bruto dhe neto.

“LAKER E BARDHË”

Bazuar në SSH 1758:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

Lloji : cilësi e parë, e freskët

Pamja e jashtme: Të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje. Lejohen lakra të pangjeshura deri: 5 % të partisë.

Pastrimi dhe gjatësia e koçanit: Të jenë të pastruara dhe me 2 – 3 gjethe të gjelbëra, të lidhura me koçanin, i cili të jetë deri në 3 cm.

Dëmtime të ndryshme mekanike, sëmundje e të çara të lehta: Lejohen deri 5 % e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyera si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma. Me sëmundje nuk lejohen.

Pesha e kokrrës:

- Për lakrën e hershme: Jo më pak se 1 kg.
- Me pjekje të mesme e të vona: Jo më pak se 1.5 kg.
- Për lakrën tip “Drinishti”, hibride etj: Jo më pak se 0.8 kg.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

“SPECA”

Bazuar në SSH 1756:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

Lloji : cilësi e parë, e freskët

Pamja e jashtme: Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri teknike.

Dëmtime (të shtypura, të gërvishtura), %, jo më shumë se: 3.

Shija: Karakteristike e kultivarit. Nuk lejohet përzjerje e specave djegës me ato jo djegës.

Gjatësia, cm:

- Për të gjatat: Mbi 10.
- Për të rrumbullaktat: Mbi 7.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

“SPINAQ”

Pamja e jashtme: Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne 1 kg.

Me rrenje te prera.

Gjatesia e kerrellit te mos jete me shume se 5cm.

Te mos kete prani te barerave te tjera.

Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 15cm.

Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe tepavyshkuara.

“B I Z E L E”

Bazuar ne STASH 1713-88.

Lloji: Bizele per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore te bizeles kokerr:

Pamja e jashtme: Të njoma, të fresketa, të pastra e të pacara, me ngjyre të kultivarit ,me pjekuri teknike dhe madhesi normale të kultivarit.

Demtime mekanike , njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje- nuk lejohen.

Kerkesat cilesore te bizeles bishtajore:

Pamja e jashtme . Të fresketa, të njoma ,të pastra, të pathyera, me ngjyre e madhesi të kultivarit.

Kokrrat ne bishtaje.Me madhesi normale të kultivarit ,të zhvilluara mire ne fazen qumeshtore, me ngjyre jeshile të hapur ,me lekure të holle ,të njome e të embel , pa shenja drunjezimi.

Demtime mekanike ,njolla ndryshku , nga antraknoza,ndezje e kalbje .Lejohen të vrara 5%.Nuk lejohen me njolla ndryshku nga antraknoza me ndezje e kalbje.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia .
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore të tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimor.

“TRANGULLI”(Kastravec)

Bazuar ne STASH 1754\88 .

Lloji :Trangull per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore :

Pamja e jashtme:Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte .

Perberja e brendshme e tulit: Me tul të forte e të lengshem. Farat e pa zhvilluara e pa kore të forte.

Madhesite: Gjeresia ne cm (diametric me i madh) deri5. Gjatesia ne cm nuk kerkohet.

Demtime mekanike (gervishtje të lehta ne lekur)ne % jo me shume se 2.

Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi .
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia .
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“MAJDANOZ”

Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne tufa.

Me rrenje te prera.

Te mos kete prani te barnave te tjera.

Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, te fresketa dhe te pavyshkura.

“SELINO”

Lloji. Selino, cilësi e parë

Kërkesat cilësore

Pamja e jashtme i freskët, i pastër, i njome, me ngjyre të bardhe në jeshile , i pavyshkur dhe i lare me ujë të pijshëm.

Gjatesia e kercellit ne cm. deri ne25-30

Demtime e semundje-nuk lejohen .

Ambalazhimi dhe etiketimi Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

- Prodhuesi,
- Lloji i prodhimit,
- Cilesia
- Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskat behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Standartizimi, sipas kërkesës së AK.

“RIGON”

STASH 2420/88

Kerkesat cilesore:

Pamja e jashtme Te jete i thare, i pastruar nga kercelli, me arome dhe shije te kendshme karakteristike te vete bimes.

Ngjyra:Te jete e gjelber e erret. Nuk lejohen te kalbura te nxira , te mykura,dhe papasterti te ndryshme.

Treguesit Fiziko –Kimike

Lageshtia: Jo me shume se: 14% Lende te huaja: nuk lejohen

Ambalazhimi: Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj ,me peshe nga 100gr - 200gr.

Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur:

- Emri tregetar,
- Data e prodhimit ,
- Vendi I prodhimit,
- Menyra e ruajtjes,
- DistributorI dhe skadenca.

“HUDHRA”

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plote.Me cipe e bisht të thate, të shendosha e të plota.

Ngjyra: Me ngjyre e forme tipike të kultivarit dhe me gjatesi të bishtit deri ne 4cm.Te lidhura ne varg ose me rrjeta deri ne 250 gr.

Demttime mekanike cifla, bishta, semundje,lejohen jo me shume se 1 % e partise me demttime të lehta dhe 1 % lende të huaja (cifla, bishta). Me semundje nuk lejohen.

Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

FRUTAT

“MOLLË”

Bazuar ne STASH _____ 1752\88.

Lloji: Molle per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore:

Pamja e jashtme: pjekuria, era dhe shija: të fresketa, me zhvillim normal ,të shendosha e me bisht..Me forme ,ngjyre e shije të kultivarit ,pa deformime me 3 pjekuri teknike të njejte. Pa ere e shije të huaj.

Madhesia e kokrres (prere gjerazi, ne diametrin me të madh).

- Kultivaret me kokerr të zgjatur jo me pak se 70mm.
- Kultivaret me kokerr të rrumbullaket jo me pak se 80mm.
- Kultivaret me kokerr të vogel jo me pak se 60mm.

Demttime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura,të ngrira,njolla nga Monilia (kalbezimi),lende të huaja nuk lejohen .

Nga krimbi(pa galeri ne brendesi).Nuk lejohen.

Nga fuzikladi (kroma e pikalorja).Nuk lejohen.

Të gjitha demtimet e siperme .Nuk lejohen .

Njolla të shkaktuara nga dielli ne lekure .Nuk lejohen .

Gunga (kallo) njolla ne lekure .Nuk lejohen .

Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres nuk lejohen.

Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi dhe etiketimi:Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve ne arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike ne fuqi per cdo lloj frut dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe ne qeska plasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura, te qepura ose të ngjitura ne gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen ne arka ne menyre të tille, të cilat të ruhet freskia dhe kosistenca efrutave.

Mbi cdo ambalazh vendoset etiketa kushenohet:

- Firmaprodhuese.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia.
- Masa neto e bruto.

Transporti i frutave, të freskta, behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“ PORTOKALL”

Bazuar ne STASH 1722\88.

Lloji: Portokalle per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore :

Pamja e jashtme: të fresket, me zhvillim normal ,të shendoshe dhe me bisht. Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht perkatesisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plote.

Ngjyra, shija dhe aroma. Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur.

Madhesia e kokrres (diametri me i madh) ne mm jo me pak se 70.

Dentime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.

Lende të huaja nuk lejohen.

Gervishtje ne siperfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të siperfaqes se tyre nuk lejohen.

Të prekura nga oleooza lejohen 2 – 3 njolla per kokerr.

Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve ne arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike ne fuqi per cdo lloj fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe ne qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, te qepura ose të ngjitura ne gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen ne arka ne menyre të tille, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

Mbi cdo ambalazh vendoset etiketa kushenohet:

- Firma prodhuese.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia.
- Masa neto e bruto.

Transporti i frutave të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga dentimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

“LIMON”

Lloji: Limona

Kërkesat cilësore :

Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal ,të shëndoshe dhe me bisht.

Ngjyra, shija dhe aroma. Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të ëmbël ne të athet, pa shije të hidhur.

“BANANE”

Kerkohet cilesi e pare , te fresketa , me zhvillim normal , ne tufe , me pjekuri teknike te plote.

Ngjyra te jete jeshile ne te verdhe, me ere dhe arome te kendeshme .

Karakteristike e ketij kultivari.

Madhesia e kokrres te jete mesatare.

Dentime mekanike nuk lejohen.

Njolla te kafeta qe tregojne tejkalimin e pjekurise nuk lejohen.

Gervishtje te lekures nuk lejohen.

Zbutje te lekures nuk lejohen.

Amballazhimi te jete ne kuti kartoni standarte tipike per tregetimin e bananes.

Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Arre moskat	kg	3
2	Banane	kg	3,500
3	Bizele	kg	700
4	Borzilok	kg	3
5	Brokoli	kg	500
6	Buke gruri	kg	2,500
7	Buke integrale	kg	250
8	Buke thekre/integrale	kg	2,700
9	Caj mali	kg	14
10	Cokokrem	kg	150
11	Djath bebe	kg	270
12	Djathe I bardhe lope	kg	700
13	Djathe kackavall lope	kg	200
14	Djathe me feta	kg	35
15	Domate	kg	700
16	Fasule e bardhe/ Thjerreza	kg	500
17	Fileto pule	kg	110
18	Frut I stines	kg	4,050
19	Gjalp	kg	150
20	Gjize	kg	700
21	Hudher	kg	60
22	Kanell	kg	15
23	Karrote	kg	2,000
24	Kastravec	kg	400
25	Koncentrat pule/vici 50-60 gr	cope	300
26	Koper	kg	10
27	Kos	lit	7,000
28	Kremvice vici	kg	260
29	Kripe	kg	100
30	Kungull	kg	1,200
31	Laker e kuqe	kg	250
32	Laker e bardhe	kg	200
34	Limon	kg	1,400
35	Lulelaker	kg	650
36	Majdanoz	kg	70
37	Makarona	kg	1,000
38	Miell gruri	kg	550
39	Miell misri	kg	180
40	Mish I grire viçi	kg	150
41	Mish pule	kg	700

42	Mish vici	kg	1,000
43	Molle	kg	1,000
44	Niseshte	kg	72
45	Oriz	kg	1,000
46	Patate	kg	2,500
47	Piper I zi	kg	4
48	Pluhur pjekje	kg	8
49	Portokall	kg	1,500
50	Presh	kg	500
51	Qepe	kg	600
52	Qepe te njome	kg	70
53	Qiqra	kg	10
54	Qofte vici	copë	2,500
55	Qumesht	lit	9,000
56	Recel kumbulle/qershie	kg	250
57	Rigon	kg	20
58	Sallam vici	kg	200
59	Salse	kg	360
60	Selino	kg	100
61	Sheqer	kg	250
62	Spec I kuq	kg	250
63	Spec jeshil	kg	300
64	Spinaq	kg	800
65	Tershere	kg	680
66	Thjerreza	kg	170
67	Trahana	kg	200
68	Uje	lit	30,000
69	Uthull	lit	35
70	Vaj ulliri	lit	890
71	Vaj vegjetal	lit	359
72	Vanilje	kg	10
73	Veze	kokerr	40,000

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2020, 2021 dhe 2022, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e parshikuar e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më sipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar më sipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë emallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.3.2. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. Për produktet e mishit (mish vici, mish pule, fileto pule, kremvice etj.) të paraqitet certifikatë UNI 10854 - Standard i Sistemeve të Vetëkontrollit Higjenik bazuar në metodën HACCP) / ekuivalente dhe e vlefshme dhe ISO 22000 (Standard për Sistemet e Menaxhimit për Sigurinë e Ushqimit) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.
2. Për produktet me bazë qumështi (qumësht, kos, djath I bardhë, djath kackavall etj.) të paraqitet certifikatë ISO 22000 (Standard për Sistemet e Menaxhimit për Sigurinë e Ushqimit) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit. Produktet me bazë qumështi, gjatë dorëzimit të tyre pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të shoqërohen gjithmonë me certifikatën përkatëse të analizës baktereologjike.
3. Për produktet bimore fruta - perime (mollë, portokall, domate, kunguj, kastravec, brokoli, qepë, hudhër etj.) të paraqitet certifikatë Global G.A.P. - Standard i praktikave të mira bujqësore) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin dhe certifikata përkatëse e prodhuesit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 1 (një) automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer).

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leja e transportit të mallrave (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), akt miratimi higjeno-sanitar dhe foto përkatëse.

Për mjetet me rrota, që shënohen në regjistra publike, që merren me qira, të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi dhe leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leja e transportit të mallrave (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), akt miratimi higjeno-sanitar dhe foto përkatëse.

